



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d dhe neni 14 paragrafi 14.1 të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), dhe nenit 34, paragrafi 34.1, pika d e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01.nr.110-392, dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur me datën 29.06.2022, merr këtë

VENDIM
PËR CAKTIMIN E LOKACIONIT PËR NDËRTIMIN E INSTITUCIONIT
PARASHKOLLORË NË LAGJEN "KOLOVICË E RE" NË PRISHTINË

- I. Miratohet Vendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Institucionit parashkollorë në lagjen "Kolovicë e re" në Prishtinë.
- II. Lokacioni nga pika I e këtij vendimi gjendet në kuadër të Planit Zhvillimor Urban i miratuar me Vendimin e KK të Prishtinës nr.01 nr. 035-181427 dt. 24.09.2013, parcela kadastrale me nr. 875-1 Zk Prishtinë (ka sipërfaqe kadastrale prej 5.2Ha, ndërsa sipërfaqja/zona e planifikuar për ndërtim të IP është rreth 0,45Ha). Pronësia e parcelës nr. 875-1 Zk Prishtinë është pronë shoqërore K.K Prishtinë.
- III. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë skicat e lokacionit të cekur në pikën II të këtij vendimi dhe ekstrakti nga PZHU.
- IV. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Planifikimit Strategjik, Drejtoria e Financave dhe Drejtoria e Kadastrit, Drejtoria e Urbanizmit, Drejtoria e Pronës.
- V. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në gjuhë zyrtare në web-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01-353/01-151669/22, më 30.06.2022

KRYESUES I KUVENDIT
Fehmi Kufina



ARSYETIM

Në bazë të takimeve të zhvilluara ndërmjet Drejtorisë së Arsimit dhe Drejtorisë së Planifikimit Strategjik, por edhe duke u bazuar në kërkesat dhe nevojën për rritjen e kapaciteteve të institucioneve publike është arritur akordimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Institucionit Parashkollorë në kuadër të lagjes Kolovicë e re, në Prishtinë.

Drejtorja e Planifikimit Strategjik, sipas kërkesës së lartë cekur ka identifikuar lokacionin për ndërtimin e I.P i cili gjendet në kuadër të Planit Zhvillimor Urban i miratuar me Vendimin e KK të Prishtinës nr.01 nr. 035-181427 dt. 24.09.2013 (*parcela e propozuar për ndërtimin e Institucionit Parashkollor sipas Planit Zhvillimor Urban, shtrihet në zonë të destinuar për banim individual*), parcela kadastrale me nr. 875-1 Zk Prishtinë (*ka sipërfaqe kadastrale prej 5.2Ha, ndërsa sipërfaqja/zona e planifikuar për ndërtim të IP është rreth 0,45Ha*) pronësia e parcelës nr. 875-1 Zk Prishtinë është pronë shoqërore K.K Prishtinë.

Bazuar në gjendjen faktike konstatojmë se në kuadër të parcelës ka shtëpi të ndërtuara ndërsa në zonën e propozuar për ndërtim të institucionit parashkollorë është sipërfaqe e zbrazët, ndërsa tereni ka pjerrtësi të lehtë.

Harmonizimi i planeve ndërmjet veti do të bëhet gjatë procesit të hartimit të planeve hapësinore siç është Plani Zhvillimor Komunal, Harta Zonale e Komunës dhe Plani Zhvillimor Urban (*parcela e planifikuar për ndërtim të IP*).

Bashkangjitur:

- skica e lokacionit të propozuar,
- ekstrakti nga plani zhvillimor urban.



- Pjesa grafike nga Plani Zhvillimor Urban nr. 01 nr. 035-181427 dt. 24.09.2013;

